



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.05.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Raporti vjetor i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017 – kthimi i përgjigjeve të pyetjeve dhe diskutime.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Xhevit Bushaj, Pjerin Ndreu, Përparim Spahiu dhe Edmond Haxhinasto.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Dashamir Shehi, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Agron Shehaj, Nadire Meçorapaj dhe Reme Lala.

Të ftuar:

Pajtim Melani – Kryetar i Bordit Drejtues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Ervin Koçi – Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi!

Presim edhe pak që të vijnë deputetët e PD-së.

Anastas Angjeli – Duhet t'i respektojmë?

Erion Braçe – Patjetër, pasi nuk e filloj dot mbledhjen pa ata!

Ka ndonjë media tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, unë mendoj se lamë kohën e mjaftueshme për zonjën Tabaku dhe njerëzit e saj.

Fillojmë mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

Sot në rendin e ditës së punës së kësaj mbledhjeje kemi diskutime rreth raportit për veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017, ndërkohë që kemi pasur në dispozicion të gjitha përgjigjet e dy seancave të zhvilluara për pyetjet e bëra nga ana e Bordit të Autoritetit dhe nga vetë drejtori Ekzekutiv i Autoritetit.

Besoj se jemi gati të fillojmë sot diskutimin e domosdoshëm dhe të nevojshëm lidhur me të. Por, para se të kalojmë aty, zoti Drejtor, unë i lexova edhe një herë të gjitha përgjigjet tuaja për pyetjet dhe kam disa pyetje të shkurtra, gjithnjë nëse ju mund të përgjigjeni, për t'i qartësuar deri në fund disa pika të rëndësishme dhe që lidhen me veprimtarinë e Autoritetit gjatë vitit 2017.

Së pari, nga raporti vjetor i institucionit, po ashtu edhe nga përgjigjet tuaja në komision ndaj pyetjeve, është referuar: “Janë kryer verifikimet e të gjitha IP-ve në sistem dhe janë mbyllur të gjitha IP-të që rezultonin aktive, por që nuk bazoheshin në rregulloret e miratuara nga AMF-ja. Është hequr IP-ja e *broker*-it dhe regjistri online i sigurimit të detyrueshëm motorik, i cili tregton TPL-në, kartonin jeshil dhe policën kufitare që nga muaji nëntor 2017”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu keni thënë këtu.

Dua të di, si është referuar ky rregullim në rregulloren përkatëse, të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në shkurt të vitit 2018?

Ervin Koçi – Me sa më kujtohet, në muajin shkurt ne miratuam një rregullore të re të regjistrimit të shitjeve online, që është bërë pikërisht për të rregulluar të gjithë procesin e shitjeve. Absolutisht, sipas rregullores, nuk lejohet më të ketë IP, përveçse shoqëritë. Vetëm shoqëritë kanë të drejtë të kenë IP.

Erion Braçe – Zoti drejtor, unë e kam lexuar dhe rregulloren që keni miratuar në shkurt të vitit 2018 dhe nuk gjej asnjë ndryshim në raport me atë që ka qenë në rregulloren e mëparshme të Autoritetit për këtë çështje.

Ervin Koçi – Besoj se edhe në rregulloren e mëparshme nuk lejohej që një broker të ketë IP.

Erion Braçe – Domethënë, aktiviteti, ajo që ju keni gjetur dhe e keni eliminuar, ka qenë i paligjshëm në raport me rregulloren e mëparshme?

Ervin Koçi – Besoj se po.

Erion Braçe – Ka qenë e paligjshme. A mban njeri përgjegjësi për këtë punë?

Ervin Koçi – Faktikisht, në të gjitha rastet kur gjendet paligjshmëri, gjithmonë gjërat shkojnë te përgjegjësitë. Por, normalisht, ajo është hapur në vitet 2012-2013, me sa pyeta, dhe nuk është se ne gjetëm informacionin e duhur apo të kishte ndonjë gjë për mënyrën se si ishte hapur ajo.

Erion Braçe – Me sa keni pyetur ju, apo me sa e keni audituar këtë çështje?

Ervin Koçi – Jo, me sa u kërkua në shkresat e të gjithës se si ishte operuar.

Erion Braçe – E kuptova.

Pyetja e dytë, nga Autoriteti, edhe në raport, por edhe në njoftimet që ju keni nxjerrë dhe i keni bërë publike, është raportuar, ndër të tjera, edhe licencimi i një burse private, apo jo? Nga aplikimi për licencim deri te lëshimi i licencës, nga verifikimi që kreva unë, ka kaluar më shumë sesa një vit. Tani, pyetja që kam unë jo vetëm për ju, por më bën përshtypje për një sërë institucionesh në këtë vend, është: pse u desh një vit për dhënien e licencës?

Ervin Koçi – Bursa e parë private e ka marrë licencën, në mos gabo, në muajin qershor të vitit të kaluar. Ka qenë një proces, të cilin unë e kam gjetur kur kam shkuar në detyrë në mesin e muajit prill. U pa i gjithë dokumentacioni përkatës dhe i gjithë dokumentacioni ishte në rregull, konform legjislacionit në fuqi.

Në licencë kemi thënë që për një vit bursa duhet të operojë, që kur ka filluar aktivitetin e saj, pra në muajin shkurt, sepse ishte instalimi i sistemeve të bursës, sidomos i sistemeve informative, që janë të rëndësishme... Është marrë sistemi i bursës së Sllovenisë, është përgatitur kuadri rregullator dhe janë ndjekur të gjitha hapat e tjerë në mënyrë që ajo të funksionojë.

Tashmë ajo e ka filluar funksionimin vetëm në shitjen e bonove të thesarit, pra të qeverisë, dhe ne i kemi dhënë afat që për një vit ajo duhet të shesë vetëm letra qeveritare. Në qoftë se do të shikojmë performancën e saj, njëkohësisht edhe kuadrin rregullator, u kemi

kërkuar edhe operatorëve në bursë që të futen operatorë të tjerë, qoftë edhe strategjikë nga vendet e huaja, në mënyrë që të krijojmë më shumë besim te qytetarët dhe te konsumatorët.

Erion Braçe – E kuptoj, madje keni bërë shumë mirë që e keni vendosur në këtë lloj sistemi kohor verifikimi, mundësie rritjeje e të tjera me radhë, por unë nuk kuptoj pse ju duhet një vit kohë për t'i dhënë licencën, domethënë një vit kohë nga paraqitja e kërkesës deri në dhënien e licencës. Për çfarë?

Ervin Koçi – Faktikisht, kur kam marrë detyrën në mesin e muajit prill, më është kërkuar një takim...

Erion Braçe – Shikoni...

Ervin Koçi – Ta them se...

Erion Braçe – Më falni, kur flas për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nuk ju kam parasysh vetëm juve, por edhe atë para jush, edhe atë para asaj tjetrës e kështu me radhë!

Që të jemi të qartë, po flasim për institucionin, jo për ju personalisht.

Ervin Koçi – Absolutisht.

Po flisja për angazhimin qëkur kam shkuar unë dhe për t'i dhënë zgjidhje asaj çështjeje.

Erion Braçe – Shikoni, edhe një herë, se gjatë gjithë këtij raportimi ju flisni thjesht dhe vetëm se çfarë keni bërë ju në atë fashën kur jeni emëruar në detyrë. Nuk më intereson kjo mua, por më intereson institucioni dhe për ato gjëra që nuk janë bërë, përgjegjësia të ndahet dhe të mbajë përgjegjësi, deri në fund, nga i pari deri te bishti i kavallit!

Ervin Koçi – Po them edhe çfarë u kërkova në momentin kur bëmë takimin. Në atë moment kishte edhe dy-tre dokumente të tjera, që i sollën dhe brenda muajit ata morën licencën. Flas në aspektin e dokumentacionit, sepse duke qenë edhe licenca e parë e një burse private, dokumentacioni i bursës është shumë voluminoz.

Erion Braçe – Në rregull.

Në fakt, pyetja e tretë nuk lidhet me raportimin për vitin 2017, por meqenëse edhe këtu u përmend, dua të di: meqenëse gjatë vitit 2018 është dhënë një licencë për operimin si shoqëri administruese fondesh (e ka emrin, por nuk po e përmend), si dhe e ka miratuar AMF-ja për fondin e investimit. Ky aplikim ka marrë gati një vit kohë deri në lëshimin e licencës dhe përfituesi i fundit i shoqërisë është një shtetas i huaj, apo jo. Duke qenë se përfituesi i fundit është ky, a ka depozituar në AMF, në dokumentet e aplikimit, edhe vendimin e ortakut të vetëm për iniciimin e një zinxhiri kompanish, që do të mbërrinte deri në Shqipëri, dhe do të operonte në investime dhe në tituj? Në vijim, pse ka një kategori

aplikimesh për licenca, që zgjasin me muaj të tërë dhe gjithmonë në fund përfundojnë me dhënien e licencës?

E treta, jemi përsëri te pyetja e tretë: ky zotëri, që zotëron këtë kompani, a ka ndonjë përvojë në administrim fondesh? Po kompanitë e zinxhirit që të çojnë te kompania e fundit që keni licencuar, a kanë ndonjë përvojë të mëparshme në administrimin e fondeve?

Ervin Koçi – Besoj se në muajin janar do t'ju ftoj të shkojmë te të gjithë sektorët (...) që kemi pasur, sepse të licencosh një fond investimesh kërkon shumë informacion. Pa diskutim (duke e nisur përgjigjen nga pyetja e fundit), ka aktivitet në fondin e investimeve në Maqedoni. Ne kemi komunikuar me autoritetin maqedonas dhe kemi marrë opinionin e tij për mënyrën e funksionimit, por ka edhe në Serbi me autoritetin e së cilës kemi komunikuar për aktivitetin e saj, por nuk na ka ardhur ende përgjigja nga autoriteti serb.

Njëkohësisht, kemi komunikuar edhe me kompaninë mëmë në Austri. Pra, ne kemi pasur komunikime dhe kur jep një licencë të caktuar, sidomos për fond investimesh, është një proces që realisht zgjat dhe ka dokumentacion pa fund dhe njëkohësisht, ka rregullore, të cilat duhen përmirësuar, ka kthim përgjigjesh.

Unë ju siguroj se edhe kur kam kërkuar takim, e kam realizuar atë, duke marrë të gjithë kohën e duhur dhe të gjithë angazhimin e stafit pa pasur asnjë procedurë burokratike për ta zvarritur (gjë që nuk diskutohet fare nga AMF-ja) dhe njëkohësisht duke pasur të gjithë eksperiencën dhe përvojën e duhur për të operuar në këto tregje, të cilat normalisht ashtu siç kanë fitime të larta, kanë edhe risqe të larta.

Ne, si autoritet, kemi bërë një analizë të plotë të riskut për këtë fond dhe padyshim, e kemi diskutuar këtë edhe me konsulentët, edhe me partnerët dhe besoj se në të gjithë aktivitetin e saj do të ketë një mbikëqyrje shumë prudente. Unë nuk besoj, se kjo shoqëri do të sjellë probleme në tregje. Nga eksperiencia që ka dhe nga përgjigjja shumë pozitive që na ktheu autoriteti maqedonas, besoj se mund të jetë diçka pozitive për zhvillimin e tregut në Shqipëri.

Erion Braçe – Është surprizë për mua aktiviteti në administrimin e fondeve në Maqedoni, të them të drejtën. Mua më rezulton se i gjithë rrjeti i kompanive që zotërohen nga ky zotëri, operojnë në fushën e sigurimeve, jo në fushën administrimit të fondeve.

Ndërkohë, zotëria vetë më rezulton të jetë ortak në një kompani tjetër, jashtë zinxhirit të kësaj kompanie, që administron fonde. Pra, ky është ortak në një kompani tjetër, që administron fonde, por në zinxhirin e kompanive që të çojnë te kjo kompani, nuk më rezulton

të ketë ndonjë aktivitet të mëparshëm në administrim fondesh. Kjo e Maqedonisë, është e re për mua.

Do të doja të më vinit në dispozicion informacionin, që materializon aktivitetin e kësaj kompanie në Maqedoni.

Ervin Koçi – Absolutisht po.

Patjetër, që sot.

Erion Braçe – Patjetër.

E fundit: unë bëra një pyetje këtu dhe dëgjova edhe përgjigjen tuaj. Më pas, ish-kolegët e mi gazetarë më referuan, se ka një publikim të dy gazetarëve, të cilët raportojnë me shqetësim, se në territorin e RSH-së operojnë pa licencë 80 subjekte, që shërbejnë si *call center*, por që në fakt, u shërbejnë skemave mashtruese për shtetasit e vendeve të tjera.

Dua të di (dhe po ju pyes për herë të dytë), nëse keni ju dijeni për këtë veprimtari të palicencuar, e cila përbën një vepër të rëndë penale sipas Kodit tonë Penal. Për më shumë, që Shqipëria ka një përvojë më të hershme në mashtrime të këtij lloji.

Së dyti, a keni kontaktuar ju, si autoritet me investiguesit e këtij rasti për të marrë informacione të detajuara mbi këto 80 kompani, për t'ua referuar edhe institucioneve të tjera ligjzbatuese, për t'i dhënë fund një mashtrimi që vijon përmes telefonit pothuajse çdo ditë, me target të posaçëm shtetasit që humbasin para përmes këtij mashtrimi?

Ervin Koçi – Edhe ne jemi në dijeni të atij shkrimi, bile kemi pasur një kontakt dhe kemi dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm. Faktikisht në informacionin e siguruar nëpërmjet medias apo edhe nëpërmjet ankesave që mund të vijnë, jemi informuar se ekzistojnë shoqëri të tilla, të cilat operojnë, sidomos me tregjet e huaja për shitjen e produkteve financiare. Për këtë, nëse ata janë licencuar nga brokera të BE-së, është një gjë shumë pozitive, sepse të paktën janë të kontrolluar, por më e keqja është që mund të jenë platforma fantazma për të vjedhur qytetarin dhe nesër mund të fshihen.

Ne u kemi drejtuar disa shkresa Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, SHISH-it, njëkohësisht dhe Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Kam zhvilluar edhe takime 2-palëshe. Takimi më i rëndësishëm ishte ai me SHISH-in dhe po e sqaroj në detaje, megjithëse mund të isha pak më i rezervuar. Jam takuar me drejtuesin e SHISH-it, të cilit i kam kërkuar të më japë emrat e këtyre shoqërive, në mënyrë që ne të procedojmë, duke njoftuar Policinë e Shtetit. Kam propozuar që të mblidhemi 5 institucionet për të bërë një plan pune se si do të operojmë me këto shoqëri.

Duke qenë se institucioni ynë nuk kishte certifikatë sigurie të marrë nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK-ja), kemi komunikuar me të dhe tani jemi në fazën përfundimtare, ku ne do të mund të marrim informacion nga SHISH-i, sepse nëse nuk ke certifikatë sigurie, SHISH-i nuk të jep informacion. Tani jemi në fazën përfundimtare. Kemi të gjitha shkresat zyrtare, ku kemi vënë në dijeni Policinë e Shtetit dhe të gjitha institucionet në mënyrë që ne të mund të operojmë. Shkresën e fundit zyrtare e kam bërë para një muaji, ku i kam kërkuar të mblidhemi si institucione, në mënyrë që të kemi një plan konkret veprimi.

Problemi është se këto shoqëri marrin më shumë shtetas të huaj dhe ky mund të jetë një problem kombëtar për vendin nesër, sepse ata mashtrojnë qytetarë të huaj dhe nesër nga institucionet ndërkombëtare mund të na kthehet një problem, sepse kjo veprimtari mund të shërbejë për pastrim parash.

Pra, jemi lidhur me të gjitha institucionet partnere në vend. Ditën e djeshme ka ardhur nga DSIK-ja një informacion që thotë se janë në fazën përfundimtare për pajisjen e disa personave me certifikatë në mënyrë që të kenë mundësi të marrin informacion të klasifikuar dhe besoj se pas kësaj, do të kalojmë në veprime konkrete, si autoritet.

Ju siguroj, kryetar, se jemi të angazhuar për të ndarë çdo informacion që na vjen si autoritet, me verifikime direkte me autoritetet, siç është Krimi Ekonomik i Policisë së Shtetit, Hetimi Tatimor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, SHISH-i dhe Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave për subjektet që mund të shërbejnë për pastrimin e parave nga elementë të ndryshëm kriminalë.

Erion Braçe – Faleminderit!

Fillojmë me diskutimet.

Kush e do fjalën?

Urdhëroni!

Evis Kushi - Faleminderit, zoti kryetar!

Ndërkohë, falënderoj së pari drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i cili vjen për herë të katërt në komision për raportimin e punës së bërë për vitin 2017!

Padyshim, çdo herë që vini, nuk është e tepërt, madje ia vlen, sepse AMF-ja është një institucion shumë i rëndësishëm, me impakt jo vetëm në institucionet financiare në vend, por me një impakt dhe me një ndjeshmëri të lartë edhe te publiku, edhe te qytetarët.

Kështu, çdo herë që vini ia vlen, sepse diskutimet, debatet janë të gjitha janë në funksion të përmirësimit të punës në të ardhmen.

Në fakt unë, si relatore e komisionit për këtë çështje, në seancën e parë që zhvilluam, paraqita edhe vlerësimin tonë për punën e AMF-së për vitin 2017, duke përfshirë aty edhe arritjet, edhe problematikat që kanë nevojë të adresohen në vazhdimësi.

Sot, meqë jemi në seancën e diskutimeve, më lejoni që të shpreh shumë shkurt 2-3 konsiderata në lidhje me këtë çështje.

E para, AMF-ja është një institucion, i cili ka trashëguar problematika të mbartura ndër vite. Këtu dua të përmend 2 më kryesoret.

Së pari, fondi i kompensimit, i cili trashëgon detyrime të prapambetura, të papaguara ndaj qytetarëve, ndaj personave të dëmtuar.

E dyta, një problematikë e viteve të fundit, ka qenë mungesa e komunikimit ose mosfunksionimi i stafit në të gjitha hallkat.

Një problem që ne kemi evidentuar edhe në vitin e kaluar, ka qenë komunikimi i acaruar apo mungesa e komunikimit korrekt midis drejtorit Ekzekutiv dhe drejtorit të Bordit, gjë që sillte problematika në të gjithë mbarëvajtjen e punës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Gjatë vitit 2017 ka pasur përmirësime të ndjeshme në disa aspekte.

Së pari, dua të theksoj rritjen e komunikimit me qytetarin dhe mbrojtjen e tij, madje puna disamujore është finalizuar edhe me hartimin e një strategjie shumë të qartë në këtë drejtim.

Së dyti, futja në rrugën e zgjidhjes së fondit të kompensimit, të cilin e përmenda pak më lart. Statistikat, pra shifrat që ju keni raportuar, tregojnë pa dyshim një ulje të ndjeshme të detyrimeve të prapambetura ndaj qytetarëve.

Së treti, hartimi i projektligjit të ri, të cilin ju e keni sjellë dhe ne presim më pa durim ta trajtojmë, sepse është një projektligj që pa dyshim do të përmirësojë dhe do t'i japë zgjidhje problematikës së Byrosë Shqiptare të Sigurimeve. Këtu dua të përmend edhe opinionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore. Konkretisht, FMN-ja e vlerëson progresin e bërë nga AMF-ja, duke u shprehur se ka një përmirësim rrënjësor vital në drejtim të mbikëqyrjes së tregut të kapitaleve dhe fondeve, duke përmendur hartimin e bazës rregullatore. Nga ana tjetër, Banka Botërore vlerëson përmirësimin e komunikimit të brendshëm apo përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet drejtorit Ekzekutiv dhe kryetarit të Bordit apo në përgjithësi të Bordit të AMF-së. Megjithatë, pavarësisht këtyre përmirësimeve,

ka ende shumë punë për të bërë, sepse, me sa mbaj mend, drejtori i ri është zgjedhur në prill të vitit 2017, pra nuk ka qenë një vit i plotë dhe ka qenë e pamjaftueshme si kohë, sepse tregu financiar është një treg shumë i vështirë dhe ka ende shumë problematika. Ne duhet të fokusohemi shumë te këto problematika, në mënyrë që të japim një zgjidhje sa më të shpejtë.

Dua të theksoj se janë të gjitha mundësitë. Me sa di unë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i ka kapacitetet, ekspertët dhe profesionistët. Natyrisht që kemi besim te drejtori i ri, i cili ka karrierën, eksperiencën dhe formimin e duhur.

Edhe ne si Kuvend i Shqipërisë, sidomos Komisioni i Ekonomisë, do të vazhdojmë monitorimin, kontrollin dhe, në bashkëpunim me ju, do t'u japim zgjidhje sa më shpejt këtyre problematikave, të cilat i paraqitëm në raportin e vlerësimit dhe pa dyshim që do t'i reflektojmë edhe në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë.

Ajo që është plaga më e rëndë e këtij institucioni është fondi i kompensimit. Keni bërë përmirësime, por ka ende shumë për të bërë. Kështu që duhen të bashkëpunojmë të gjithë, sepse impakti te qytetarët është shumë i madh. Jemi në pritje të diskutimit të ligjit të ri, i cili shpresojmë se do ta përmirësojë edhe më shumë këtë treg.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Kushi, si relatore e komisionit, për përgatitjen e kësaj mbledhjeje dhe të raporteve, të cilat i kanë dhënë seriozitetin e duhur seancës dëgjimore që u bë për vlerësimin e punës së AMF-së për vitin 2017!

A ka ndonjë propozim tjetër? Meqenëse nuk ka propozime dhe, në kushtet kur mungon Partia Demokratike, më lejoni mua të them dy fjalë.

Të nderuar drejtues të AMF-së, ju si drejtor Bordi dhe ju si drejtor Ekzekutiv i Autoritetit, në vlerësimin tim personal, si deputet i Kuvendit të Shqipërisë apo si deputet i këtij komisioni, puna e AMF-së për vitin 2017, duke i përfshirë të dy drejtuesit, edhe atë që ka qenë më herët, edhe ju, ka qenë e pamjaftueshme.

Janë disa aspekte, për të cilat pyeta, por mora përgjigje gjatë seancave dëgjimore në këtë komision, të cilat më shtynë të arrija në këtë konkluzion.

E para, ka të bëjë me ligjshmërinë. Po bëj një parantezë të shkurtër. Ne të tre dhe një pjesë e kolegëve kemi qenë në këtë komision dhe një nga elementet themelore, me të cilin jemi marrë, ka qenë ligjshmëria jo vetëm e AMF-së në veprimtarinë e tij, por edhe ligjshmëria në tregun e sigurimeve, të kapitaleve në këtë vend. Për fat të keq, struktura kyçe në tregun e sigurimeve, Byroja Shqiptare e Sigurimeve, noton në paligjshmëri nga mëngjesi deri në darkë. Ishte në paligjshmëri dhe vazhdon të jetë ende në paligjshmëri. Natyrisht, kjo

ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, ish-drejtoreshën Ekzekutive të këtij Autoriteti jo vetëm për paligjshmërinë që ka lejuar, por edhe për marrëdhënien që ka krijuar me Bordin e AMF-së, natyrisht edhe ju.

Më duhet të përsëris atë, për të cilën ju pyeta një seancë më parë, por, tashmë po e them si konkluzion. Drejtori Ekzekutiv i Byrosë Shqiptare të Sigurimeve nuk ka akt miratimi nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Megjithatë, është në detyrë të paktën që nga muaji janar i vitit 2016. Arsyeja është shumë e qartë: AMF-ja ka pretenduar se drejtori nuk i përmbush kriteret ligjore. Pikërisht, Asambleja, organi udhëheqës i këtyre shoqërive, nuk ka propozuar kandidaturë tjetër dhe AMF-ja është e detyruar ta pranojë këtë fakt. Kjo është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e ish-drejtoreshës Ekzekutive të AMF-së, por ju, pavarësisht se ju pyes disa herë në komision, nuk arrini ta identifikoni. Meqë ju nuk e bëni, po identifikoj unë përgjegjësinë e saj.

Shkarkimi i drejtorit, ashtu siç u deklarua edhe këtu në komision, është një akt ndaj një drejtuesi të pamiraturar, pra po mundohemi të rregullojmë një paligjshmëri me një akt për një njeri, që nuk e meriton fare atë titull, për shkak se Autoriteti nuk ka dhënë miratimin e tij. Këtë gjë e konfirmon edhe vendimi i fundit i Bordit të AMF-së, ku cilësohet se është drejtor i komanduar. Për të qenë konkretë, është vendimi nr. 86, datë 07.05.2018, pika 1 dhe vendimi është publik. Pikërisht kjo çështje më shtyn të mendoj se puna, që ju keni bërë në drejtim të ligjshmërisë të këtij institucioni kaq të rëndësishëm, është e pamjaftueshme. Duhet që të viheni në lëvizje menjëherë për ta kthyer në ligjshmëri pikërisht këtë institucion, duke filluar që nga drejtuesit e tij deri të veprimtaria që i ka ngarkuar ligji Byrosë Shqiptare të Sigurimeve.

Çështja e dytë, dhe unë nuk mund t'i mohoj përpjekjet që ju keni bërë, ka të bëjë me fondin e kompensimit, sepse ka qenë një nga pikat kyçe, tek e cila është investuar FMN-ja dhe Banka Botërore. Kjo është e shkruar në mënyrë të qartë në dokumentin që lanë këtu fill pas analizës që i bënë sistemit financiar shqiptar në vitin 2014. Ky ka qenë angazhimi i drejtpërdrejtë i këtij komisioni, personalisht edhe i juaji, si anëtar dhe si relator i këtij komisioni, por që nuk ka marrë një zgjidhje përfundimtare. Po ju kujtoj se në qoftë se e para kishte të bënte me ligjshmërinë e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, kjo e dyta ka të bëjë drejtpërdrejtë me qytetarët e Republikës së Shqipërisë, dhe para tyre, si unë dhe kolegët e m'i, besoj se mandati apo karrigia e kujtdo tjetri nuk vlen fare.

Gjatë seancës së pyetjeve ju pyeta disa herë në komision në lidhje me këtë çështje dhe më duhet t'ju them se fondi i kompensimit ka vijuar të trajtohet me të njëjtën frymë, si në

rastin e drejtoreshës së parë Ekzekutive, që mban përgjegjësi të rënda lidhur me këtë çështje, por edhe gjatë muajve që jeni ju drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Vendimet e Bordit të AMF-së për fondin e kompensimit të vitit 2018 janë njësoj në përmbajtje dhe në mekanizma, si dhe vendimet e mëparshme, që nuk e kanë zgjidhur situatën, mund ta kenë zbutur, por nuk e kanë zgjidhur situatën përfundimisht.

Edhe vullneti për zbatimin e vendimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mbetet i njëjtë, si nga Asambleja e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, ashtu edhe nga Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare. Vendimet e asamblesë nuk janë në përputhje dhe këtë duhet ta thoshit ju me zë të lartë, nuk janë në përputhje me vendimet tuaja, si Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare, madje edhe të gjykatave. AMF-ja nuk ka ushtruar, edhe pas ndryshimit të drejtuesve, pra nga drejtoresha e mëparshme Ekzekutive e deri tek ju, autoritetin për të siguruar zbatimin e vendimeve tuajat, jo tonat. Vendimi i Bordit të Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare, nr. 86, datë 07.05.2018 pikat 2 dhe 3 dhe pjesa konstatuese e këtij vendimi konfirmon se vendimi i Bordit për fondin e kompensimit të vitit 2018, nuk është zbatuar nga Asambleja e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve. Edhe ju e bëtë të qartë këtu, që ky vendim nuk është zbatuar prej tyre. Por nuk e kuptoj pse Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare duhet të priste raportimin në Kuvend, që të merrte një vendim të dytë? Vendimi nr. 217, datë 28.12.2017 për fondin e kompensimit për vitin 2018 i kërkon Byrosë: “të kërkojë fond minimalisht në vlerën 895 milionë e ca; të bëjë shlyerjen e menjëhershme (thuhet në atë vendim që e keni marrë ju) të një pjese të dëmeve të prapambetura në masën 923 milionë; të raportojë në AMF planin e shpërndarjes brenda datës 25 janar 2018”. Vendimi i marrë më 7 maj konfirmon se këto pika nuk janë përmbushur dhe as shoqëria e auditimit nuk rezulton e përzgjedhur, sepse e verifikuam edhe këtu këtë. Kërkuam një auditim mbi të, ju thatë: “Kemi bërë një inspektim”, apo jo? Mbi të gjitha, nuk është kryer shlyerja e menjëhershme prej 923 milionë lekësh, ku të paktën unë, “me të menjëhershme” kuptoj pagesat që duhet të ishin bërë në javën vijuese të vendimit apo qoftë edhe në muajin vijues, në favor të qytetarëve, që presin prej vitesh të kompensohen nga këto shoqëri sigurimi.

Në vendimin e datës 7 maj, AMF-ja duke rivendosur afate ka sanksionuar edhe shkeljen e vendimit të mëparshëm të saj.

Siç e thashë edhe gjatë pyetjeve, për ne nuk ka rëndësi vendimet që ju merrni kur ato nuk zbatohen. Ju kemi dhënë të gjithë mbështetjen dhe të gjithë pushtetin e domosdoshëm që ju të ushtroni autoritetin maksimal mbi shoqëritë e sigurimit dhe mbi Byronë Shqiptare të Sigurimit për të zbatuar deri në një vendimet që ju merrni. Shoqëritë e sigurimit duhet të

kuptojnë se vendimet tuaja për ta janë të panegociueshme, por vetëm të zbatueshme. Në momentin që këto vendime nuk zbatohen, Autoriteti ka rënë.

Nisur nga së më sipër, duhet t'ju them se ligji i ri "Për sigurimin e detyrueshëm" duhet të ketë, pa asnjë lloj diskutimi, përgjegjësi të forcuar për Autoritetit e Mbikëqyrjes Financiare për t'i imponuar rregull në fondin e kompensimit dhe rritje të kërkesave për transparencë. Versionin që ju i keni sjellë Kuvendit, po ju kujtoj se atë version duhet ta sjell qeveria, pra versionin që i keni sjellë ju Kuvendit, apo në versionin që ju i keni sjellë Kuvendit, unë nuk shquaj ndonjë autoritet të shtuar, përgjegjësi të shtuara kundrejt jush në raport me fondin e kompensimit, ligjshmërinë atje dhe përmbushjen e detyrimeve nga kompanitë në raport me fondin e kompensimit. Pra, duhet ta rishikoni para se t'ia dërgoni ministrisë përkatëse dhe para se të shqyrtohet në këtë komision, përndryshe do të detyrohet ky komision ta bëjë këtë gjë.

Së dyti, deri në miratimin e këtij ligji, që me sa kuptoj do të kërkojë kohë, sepse ka një reaksion shumë të madh, qoftë nga shoqëritë e sigurimit, letra më vijë mua njëra pas tjetrës, qoftë edhe nga grupe të interesuarish, që përfaqësojnë grupe të dëmtuarish, të cilat kanë kontestim mbi ligjin. Pra, deri në momentin që do të shqyrtohet ligji i ri dhe do të miratohet ju (kjo do të jetë edhe në rezolutë), do të raportoni pranë këtij komisioni çdo 3 muaj lidhur me fondin e kompensimit, shlyerjen e detyrimeve, përgjegjësitë e secilës kompani me emër në raport kundrejt këtij fondi, të përmbushura ose jo, natyrisht mbajtjen e premtimit që bëtë këtu, para këtij komisioni, për t'u dhënë fund këtyre detyrimeve (më duket se thatë në janar të vitit 2019, apo jo). Kjo është shumë e rëndësishme për ne si komision. Unë besoj se do të jetë e rëndësishme edhe për punën tuaj.

Së treti, më lejoni t'ju them se në gjykimin tim, puna juaj ka qenë pamjaftueshme edhe në aspektin e zbatimit të disa ligjeve të tjera, që lidhen drejtpërdrejtë me tregje që ju i mbulon, ku jo do të ishit shumë më tepër aktivë dhe nuk duhet të kishit rënë pre e burokracisë së hallkave të ndryshme qeveritare, që nuk po çlirohen dot, pikërisht, nga ky fenomen i zgjatjes në kohë të përgjigjeve të qarta dhe të prera për të vënë në funksionim ligjet e miratuara nga Kuvendi.

Këtu ju pyeta për ligin nr. 107, datë 31.07. 2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin territorit", që përcakton se njëkohësisht me lidhjen e kontratës për kalimin e pronësisë së punimeve, ndërtuesi duhet t'i dorëzojë blerësit një policë sigurimi me afat 10-vjeçar me përfitues blerësin dhe me efekt nga data e përfundimit të punimeve që mbulon dëmet e ndërtesës, përfshirë dëmet ndaj të tretëve, që rrjedhin për shkak të tokës ose për shkak të

defekteve në ndërtim, ndërtimi shembet tërësisht ose pjesërisht, ose paraqet rrezik të dukshëm shembjeje ose defekte të tjera të renda, që shfaqen pas lidhjes së kontratës të kalimit të pronësisë.

Ligji është miratuar në vitin 2014. Sot jemi në ditën e parafundit të majit të vitit 2018. Ka 4 vjet që ligji nuk zbatohet. Është e pafalshme për një vend si Shqipëria, që në vijimësi ka vënë në dukje rritjen e sektorit të ndërtimit dhe në krahun tjetër edhe cilësinë e munguar në një pjesë të sektorit të ndërtimit, që të lejojë tregun e ndërtimeve pa cilësi të abuzojë, duke rrezikuar jo vetëm pasurinë e qytetarëve, por edhe jetën e tyre.

Ju thatë se keni këmbyer letra me Ministrinë e Drejtësisë. Është e pamjaftueshme kjo gjë. Këmbimi i letrave me njërin apo me tjetrin nuk i intereson këtij komisioni. Është e pamjaftueshme dhe e patolerueshme njëherësh, që ligji nuk zbatohet nga AMF-ja. Nga ana tjetër, është e patolerueshme që ligji nuk zbatohet edhe nga institucionet e tjera, që duhet të bëhen pjesë e zbatimit të këtij ligji, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën e Regjistrimit të Pasurive, noterët dhe çdo gjë tjetër.

Ne jemi këtu për këtë gjë, për zbatimin e ligjit. Nëse ne kemi ndërmarrë një politikë të caktuar në këtë Kuvend, me fokus të qartë ndihmën për qytetarët e Republikës së Shqipërisë, kjo politikë nuk mund të dështojë për shkak të moszbatimit të ligjit.

E njëjta gjë vlen edhe për çështjen tjetër, për vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1109, datë 08.08.2008, i cili parashikon se shuma e siguruar nuk mund jetë më e ulët (bëhet fjalë për minatorët) se 6 milionë lekë dhe tarifa e sigurimit minimal, 0,5% e shumës së siguruar. Edhe kjo çështje është themelore për ne.

Unë nuk e bëj dot atë që bën Lulzim Basha. Lulzim Basha është një mashtrues, një ordiner, që shkon dhe troket në derën e një minatori të dëmtuar në punë dhe nuk i jep dot zgjidhje. Të paktën, kjo ana këtej, diferencën e qartë me Lulzim Bashën e ka në këtë pikë.

Në qoftë se ne marrim një vendim, ai vendim duhet të zbatohet me çdo kusht. Nuk më intereson kush është pronari i një kompanie apo i disa kompanive rresht, të cilat refuzojnë të zbatojnë ligjin. Në qoftë se e bëjnë këtë gjë, pra nëse refuzojnë të zbatojnë ligjin, pa asnjë lloj diskutimi, duhet të përballen me forcën e ligjit.

Po e përsëris, unë nuk e bëj dot rolin e Lulzim Bashës. Jam i pazoti të bëj sikur qaj atje, ndërkohë që kam të gjithë përgjegjësinë të zbatoj ligjin deri në fund.

Puna juaj ka qenë e pamjaftueshme edhe në raport me veprimtarinë informale në tregun e sigurimeve. Pa asnjë lloj diskutimi, kur e them këtë, nuk e mohoj përpjekjen tuaj për të vendosur rregull në këtë treg, por edhe nga përgjigjet e pyetjeve që morëm prej jush, edhe

nga shqetësimi i përsëritur, që vjen nga një sërë aktorësh të tjerë që operojnë në treg, ka segmente të gjera të tregut që operojnë në informalitet.

Ajo çështja e kasës fiskale, në rastin e shitjes së policave të sigurimit, nuk ishte një çështje për të bërë lajm ditën e nesërme. Jo. Është një element kyç, që duhet të çojë deri në fund formalizimin dhe fiskalizimin e tregut.

Nuk e di çfarë keni bërë krahasuar me një javë më parë, por kjo pikë do të jetë në rezolutën për ju dhe Ministrinë e Financave, në mënyrë që të vendosni instrumentet e mjaftueshme që ky treg të kthehet në formalitet, të operojë në konkurrencë të plotë dhe të ofrojë siguri për qytetarët që duan të marrin shërbime nga ky treg.

Thënë këtë, dua ta vë theksin shumë fort te konkurrenca në këtë treg. Duhet të ketë bashkëpunim të qartë midis jush dhe Autoritetit të Konkurrencës, me qëllim që historia e çmimeve fikse dhe atyre nën kosto në këtë treg, të cilat e çojnë tregun drejt mizerabilitetit, të marrë fund, ashtu siç duhet të marrë fund edhe mungesa e konkurrencës në këtë treg.

Së fundi, siç edhe ju e keni kuptuar nga pyetjet që ju kam adresuar, por edhe nga opinionet, unë e konsideroj të pamjaftueshme nxjerrjen e përgjegjësive për të gjitha fenomenet negative që kanë ndodhur në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare para se ju të merrnit detyrën. Unë nuk e pranoj dot amnezinë në rastet kur ajo që ndryshon është thjesht karrigia. Është e papranueshme që ju, bordi, të përballeni me fenomene, të cilat kanë jetëgjatësi si fenomene negative brenda Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe përgjegjës për to të jetë vetëm një drejtor mbikëqyrjeje.

Për gjithë sa thashë, unë përgjegjësinë e ndaj me ish-drejtoreshën ekzekutive dhe me ju, me asnjë nën ju. Përgjigjeni ju për institucionin dhe jo ata që janë nën ju.

Kështu që, do kisha preferuar shumë që të paktën në vitin e parë të raportimit tuaj në këtë komision të kishit një seksion të posaçëm për të gjitha fenomenet negative që kanë ndodhur në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, të cilat kanë shkaktuar dëme të pallogaritshme në treg, një pjesë të të cilave i kemi konsumuar edhe këtu gjatë seancave dëgjimore, me të cilat, unë, ju dhe kolegët tanë deputetë jemi përballuar në këtë komision për vite me radhë.

Nuk është pak që dy kompani janë në një situatë tërësisht të papranueshme në raport me detyrimet që ato duhet të kenë kundrejt qytetarëve dhe në kushtet kur mund të infektojnë gjithë tregun jo vetëm këtu, por edhe në Kosovë dhe Maqedoni.

Pra, duhet të kishin dalë përgjegjësitë e plota për gjithsecilin, duke filluar nga drejtori ekzekutiv e deri tek i fundit, që me vendimmarrjen e tij ka krijuar atë situatë me të cilën ju

përballeni prej 1 viti, ne përballemi prej disa vitesh dhe nuk po i japim dot zgjidhje në favor të qytetarëve në të gjitha aspektet për të cilat folëm.

Ky është problemi.

Rezolutën e këtij komisioni “Për vlerësimin e punës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, e cila do t’i referohet më pas Kuvendit, do ta miratojmë javën tjetër

Mbledhja mbyllet këtu.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA